



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVETKOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KOMISIONI DISIPLINOR//DISCIPLINSKA KOMISIJA/ THE DISCIPLINARY COMMITTEE

KD.nr.03/2018

KOMISIONI DISIPLINOR, në përbërje nga gjyqtarët, Nenad Lazic, kryetar, Manushe Karaqi dhe Armend Berisha, anëtarë të Komisionit, në procedurë disiplinor kundër Xxxx Xxxxxx, Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Xxxxxxx, sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor me numër ZPD-2018-069, në procedurë të Komisioni Disiplinor i KGJK-së ka marrë numrin KGJK/KD/01/2018, për sjellje të pahijshme të përcaktuar sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2-neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer, dhe shkelje e kodit të etikës Profesionale për Gjyqtar pika II e preambulës, pika 1, 1.4, pika 5, e përcaktuar si shkelje e lehtë e pahijshme nga neni 4 lidhur me nenin 6 të rregullores nr.04/2016 Për Përcaktimin e sjelljeve të Pahijshme, sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223), në seancën dëgjimore të mbajtur në prezencën e përfaqësuesit të ZPD-së, Kadri Begolli, dhe gjyqtarës Xxxxxx Xxxxxxx, më datën 07.09.2018, në bazë të nenit 37 paragrafi 1 pika 1.3 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës merr këtë:

V E N D I M

1. Xxxxxx Xxxxxxx, Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Xxxxxxx, **është** përgjegjës për sjellje të pahijshme sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor me numër ZPD-2018-069, i njëjti në procedurë të Komisioni Disiplinor ka marrë numrin KGJK/KD/01/2018, të përcaktuar në nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2-neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer, dhe shkelje e kodit të etikës Profesionale për Gjyqtar pika II e preambulës, pika 1, 1.4, pika 5, e përcaktuar si shkelje e lehtë e pahijshme nga neni 4 lidhur me nenin 6 të rregullores nr.04/2016 Për Përcaktimin e sjelljeve të Pahijshme, sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223).
2. Për shkak të vërtetimit të sjelljes së pahijshme, gjyqtarës Xxxxxx Xxxxxxx i shqiptohet masa disiplinore Ulje e përkohshme e rrogës për 20% në kohëzgjatje prej tre (3) muaj, duke filluar prej muajit në vijim pasi vendimi të bëhet i plotfuqishëm.

A r s y e t i m

Në Komisionin Disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Zyra e Prokurorit Disiplinor ka paraqitur raportin përfundimtar me numër ZPD-2018-069, se bashku me shkresat e lëndës, më të cilin e ka ngarkuar Xxxxxx Xxxxxxx, Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Xxxxx-Xxxxxx për Xxxxxxx, për sjellje të pahijshme të përcaktuara në nenin 34 paragrafi 1 pika 1.2-neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer, dhe shkelje e kodit të etikës Profesionale për Gjyqtar pika II e preambulës, pika 1, 1.4, pika 5, e përcaktuar si shkelje e lehtë e pahijshme nga neni 4 lidhur me nenin 6 të Rregullores nr.04/2016 Për Përcaktimin e sjelljeve të Pahijshme, sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223).

Zyra e Prokurorit Disiplinor, hetimin disiplinor për sjellje të pahijshme të Gjyqtares Xxxxxx Xxxxxxx, e kishte filluar sipas detyrës zyrtare, me pretendim se ka neglizhuar funksionin gjyqësor në periudhën kohore prej 03 janar 2017 e deri me 13 dhjetor 2017, nuk ka ndërmarr veprime për të pamundësuar vjetërsimin e lëndëve, dhe në këtë mënyrë ka lejuar parashkrimin e 1972 lëndëve të natyrës së kundërvajtjeve. Për verifikimin e këtij pohimi ZPD, më datë 19 mars 2018, nga kryetari i Gjykatës ka pranuar konfirmimin për parashkrimin e shumë lëndëve nga Xxxxxx xxxxxxx, pastaj vendimin e KGJK-së me numër KGJK/nr.358/2017 të datës 13 dhjetor 2017, pjesërisht nga deklarata e marrë nga gjyqtarja, pastaj nga provat materiale siç janë pasqyra e vitit 2016, 2017, dhe numri i lëndëve të evidentuara si ne rastet e vjetërsuara. Zyra e Prokurorit Disiplinor ka prezantuar materialet nisur nga pretendimet e gjyqtares për ngarkesën e madhe me lëndë, pushimet vjetore dhe mjekësorë të sekretares së saj, si dhe pasqyrën e lëndëve më të cilat kanë qenë të ngarkuara gjyqtaret e të njëjtës lami. Këto prova sipas pretendimeve të ZPD-së kanë treguar se gjyqtarja Xxxxxx me neglizhencë kishte ushtruar funksionin gjyqësor, sepse duke ushtruar funksionin në kushte dhe rrethana të njëjta sikurse edhe të gjyqtareve të tjerë të lëmive të njëjta, ka lejuar që të vjetërsohet një numër i madh i lëndëve.

Pran këtij raporti në tërësi ka qëndruar përfaqësuesi i ZPD, duke deklaruar se pas zhvillimit të hetimit disiplinor, ZPD pretendon se ka siguruar prova të pa kontestueshme për të argumentuar së Xxxxxx Xxxxxxx, Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Xxxxxx-xxxx xxxxxx, ka kryer sjellje të pahijshme.

Gjyqtarja Xxxxxx Xxxxxxx në seancën dëgjimore të komisionit disiplinor të mbajtur me datë 07 shtator 2018, ka deklaruar se ajo kishte marr urdhër nga kryetari i gjykatës që të mos refuzoj pjesëmarrjen në trupe gjyqese, në krime të rënda, kështu që ka qenë e obliguar që sa herë të ftohej për pjesëmarrje në këto kolegje, të merrte pjesë. E gjithë kjo për shkak se gjyqtaret e lëmisë penale dhe civile në këtë Gjykatë kanë qenë shumë të ngarkuar dhe është dashur që të merren gjyqtar nga lamia e kundërvajtjes. Me tutje ka deklaruar se në vitin 2016 ka marrë pjesë në 86 seanca si anëtarë e trupit gjykues në krime të rënda, gjatë të njëjtit vit kishte plotësuar normën mujore, dhe këtë e ka dokumentuara me raportet statistikore që ndodhen në SKGJK. Ka deklaruar

se ajo është nga Prizreni dhe për tri vite ka punuar në gjykatën e XXxxxx. Për çdo ditë i ka humbur 3-4 ore në ditë udhëtimi nga Prizreni deri në Gjykatën e Klinë. Në vitin 2015, gjyqtarja kishte bërë kërkesë për transferim në Gjykatën Themelore në Xxxxxxx, mirëpo KGJK e kishte transferuar në Gjykatën Themelore në Xxxxxx. Nga qershori i vitit 2015 kur gjyqtarja xxxxxx ishte transferuar në Gjykatën Themelore në Xxxx Xxxxx XXXXXx, i ka trashëguar lëndët e gjyqtarit që ishte dal në pension. Këto lëndë kanë qenë të vitit 2012, 2013, 2014 dhe menjëherë kishte pranuar edhe lëndë të vitit 2015. Kryetari e kishte ngarkuar edhe me 240 lëndë të koleges, të vitit 2014, ashtu që në fund të vitit 2015, i ka pasur gjithsej 5000 lëndë. Në vitin 2016 i kishte pasur gjithsej 7500 lëndë, që sipas deklarimit të gjyqtares, ka qenë e pa mundur që në fund të 2016 të kryhet të gjitha.

Në vazhdim ka deklaruar se edhe sekretarja juridike për shkak të përvojës se punës ka pasur 35 dite pushim vjetor, mandej ka pasur edhe probleme shëndetësore, ka shfrytëzuar 25 ditë pushim mjekësor. Në këtë situata gjyqtarja kishte mbetur pa sekretare juridike, dhe e gjithë kjo ja kishte vështiruar shume punën. Në viti 2017 po ashtu kishte marr pjesë në 72 seanca, si anëtare e trupit gjykues, e llogaritur në kohë sipas gjyqtares Xxxxxxxx i bie 3 muaj ditë pune. Në fund të vitit 2017, sipas gjyqtares Xxxxxx ka qenë e pa mundur që të i përfundoj të gjitha lëndët. Duke u bazuar edhe në vendimin e KGJK-së për parashkrim, gjyqtarja kishte parashkruar të gjitha lëndët që ishin vjetërsuar deri në fund të vitit 2017.

E pyetur nga Komisioni se a ka pasur zëvendësim adekuate në rast të mungesës së sekretares juridike, gjyqtarja është përgjigjur që nuk ka pasur, për shkak të mungesës së sekretareve në të njëjtën Gjykat, por si zëvendësim, i kishin dërguar kohë pas kohe praktikante.

Sipas gjyqtares Xxxxxxx, lëndët që janë parashkruar në fund të vitit 2017, nuk janë lëndë të vitit 2017, këto lëndë kryesisht kanë qenë lëndë të vitit 2015 dhe 2016, e që në fund të vitit 2017, janë vjetërsuar.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i ZPD-së deklaroj se ZPD është e vetëdijshme se lëmia e kundërvajtjes dhe gjyqtaret që punojnë në këtë lami janë të ngarkuar me një numër të madh të lëndëve, dhe se kjo nuk i referohet vetëm gjykatës ku punon gjyqtarja por është shprehur si dukuri në të gjitha gjykatat, në sistemin unik të Kosovës. Gjyqtarja Xxxxxxx është me përvojë, dhe një kohë të gjatë punon në lëmin e kundërvajtjes. Me një menaxhim me ndryshe të zyrës dhe lëndëve me të cilat ka qenë e ngarkuar, e në veçanti të lëndëve të pretenduara që janë bartur nga gjyqtaret tjerë, me siguri që nuk do të kishte ndodh që lëndët në përgjithësi të vjetërsohen në fund të vitit 2017, por vjetërsimi do të ishte bërë në kontinuitet, sepse edhe vjetërsimi është një formë e vendosjes, por në aspektin procedural. Është fakt se ka pas problem me menaxhimin e zyrës, me procesmbajtësen, dhe fakti se edhe për një lëndë të vjetërsuar duhet të punohet një vendim, që zakonisht në kundërvajtje është formë standarde, blanko, mundë të bëhet edhe nga praktikanti që gjyqtarja e kishte pas në zyre. Sa i përket pushimin vjetor të sekretares juridike në vitin 2017, sekretarja ka qenë në pushim 20 dite pune.

Është e vërtet sipas ZPD-së që pjesëmarrja në kolegje e gjyqtarëve Xxxxxx karshi gjyqtarëve të tjerë të kundërvajtjes, ka qenë me e madhe. Por kjo nuk do të thotë që në vitin 2017 gjyqtarja që ka marrë pjesë në 72 seanca, dhe të gjitha këto seancat të llogariten nga një ditë pune. Kjo është edhe jashtë rregullave të organizimit të brendshëm të gjykatës, që një gjyqtar pjesëmarrës në seancë, në një trup gjykues, të lirohet apo të trajtohet si një ditë pune në gjykat. Kërkoj nga kryetari i komisionit, që raporti si i tillë të pranohet, të konstatoj se është kryer sjellja e pahijshme dhe ti shqiptoj sanksion disiplinore konform gjetjes dhe bazës disiplinore.

Gjyqtarja Xxxxxx Xxxxxxx në fjalën përfundimtare deklaroj se ajo gjithmonë i ka punuar lëndë që kanë qenë afër parashkrimit dhe se vetëm me raste, me kërkesë të palëve i ka kryer lëndët e reja. Me tutje ka theksuar se me ligjin e vjetër të kundërvajtjes, lëndët janë përcjellë nëpër komuna, sipas vendqëndrimit të të pandehurve, kështu që kur janë ardhur në Gjykat, kanë qenë afër parashkrimit. I kërkoj falje Komisionit që ka ardhur deri te kjo situatë, nuk ka qenë e qëllimshme, dhe premtuar që në të ardhmen nuk do të ndodh më.

Komisioni Disiplinor i administroj të gjitha provat në shkresat e lëndës, provat shtesë të gjyqtarëve Xxxxxx Xxxxxxx, të dhënë Komisionit dhe ZPD-së gjatë seancës, ka dëgjuar edhe deklaratën e përfaqësuesit të ZPD-së dhe gjyqtarëve të dhënë gjatë seancës, dhe pasi i shqyrtuar dhe analizuar, konstatoj se ekziston përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve Xxxxxx Xxxxxxx.

Sipas vlerësimit të Komisionit, qëndron pretendimi i ZPD-së se znj.Xxxxxx ka bërë shkelje disiplinore me të cilat është ngarkuar, dhe se rrethanat e shumta lehtësuese të cilat i ka cekur dhe ekzistenca e të cilëve është e sigurt, nuk janë të ndërlidhura nga ekzistenca e shkeljes disiplinore. Gjyqtarja është dashur që të jetë me e kujdesshme, lëndët dhe zyrën ta menaxhoj me mirë, në mënyrë që të mos vije deri të ky numër kaq i madh i vjetërsimit të lëndëve.

Në seancën për këshillim dhe votim, Komisioni njëzëri vendosi së gjyqtarja Xxxxxx Xxxxxxx është përgjegjës për sjellje të pahijshme të një gjyqtari sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2-neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer, dhe shkelje e Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar pika II e preambulës, pika 1, 1.4, pika 5, e përcaktuar si shkelje e lehtë e pahijshme nga neni 4 lidhur me nenin 6 të Rregullores nr.04/2016 Për Përcaktimin e sjelljeve të Pahijshme.

Lidhur me këtë konstatim, Komisioni në mënyrë unanime i shqipton masën disiplinore **Ulje e përkohshme e rrogës për 20% në kohëzgjatje prej tre (3) muajve**, duke filluar prej muajit të ardhshëm pasi vendimi të bëhet i plotfuqishëm.

Me rastin e shqiptimit të masës disiplinore, Komisioni, si rrethanë lehtësuese, mori parasysh ngarkesën shumë të madhe me lëndë, pjesëmarrjen në trupa gjykues në departamentin për krime të rënda, mungesën e sekretarëve juridike e cila përveq pushimit vjetor ka qenë edhe në pushim mjeksor, e kjo për shkak të gjendjes shëndetsohe në të cilin është ndodhur në atë kohë.

Në bazë të nenit 37 paragrafi 1 nën pikën 1.3 dhe paragrafit 2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR
KD-nr.03/2018, date 07.09.2018

Kryetar i Komisionit Disiplinor
Nenad Lazic

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në Prishtinë, brenda 15- ditësh nga dita e pranimet të Vendimit.

Vendimi u dërgohet:

- Nehat Idrizi, kryesues i KGJK-ës;
- Arianit Salihu, u.d drejtor i Zyrës së Prokurorit Disiplinor;
- Xxxxx XXxxxxx, kryetar në Gjykatën Themelore në Xxxxxxxx;
- Xxxxxx Xxxxxxx, Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Xxxxxxx;
- Departamentit të Administratës dhe Personelit në SKGJK;